



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLICA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____



_____ р./в.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 84-të, të mbajtur më 31.03.2023, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-1776/1 të datës 09.03.2022, kundër personit-----
-, anë tar i -----, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në pajtim me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka kompetencë për veprim në rastin e lëndës.

Lënda me numër 12-1776/1 të datës 09.03.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur më datë 09.03.2022 është dorëzuar denoncim kundër personit-----
-----, anë tar i tanishëm në, dhe është formuar lënd me numër 12-1776/1 të datës 09.03.2022.

Në denoncim parashtruesi thekson se ----- – anëtare e Këshillit programor në -----, në një bisedë joformale deklaroi se mund të punësojë njerëz në ----- për një shumë të përshtatshme parash dhe se këtë e praktikojnë edhe anëtarët e tjerë të Këshillit programor. Parashtruesi i denoncimit, pa specifikuar persona dhe veprime konkrete, kërkon që KSHPK –ja ta hetojë punësimin e personave në Radiotelevizionin maqedonas që janë rezultat i marrjes së rryshfetit nga i raportuari dhe nëse konstatohet se dyshimet janë të bazuara, , personi i raportuar duhet të sanksionohet siç duhet.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja arriti në përfundimin se denoncimi ka të bëjë me pretendimet që rrjedhin nga bisedat jozyrtare ndërmjet parashtruesit dhe personit të denoncuar, për ngjarje për të cilat nuk ka indikacione se ato kanë ndodhur, pas së cilës KSHPK-ja konkludoi se nuk ka juridiksioni për të vepruar në rastin në fjalë .

Duke pasur parasysh të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përpiloi: A.R.M.
Miratoi: K.N.,anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHETËTOR
PËR PARANDLAIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar,
Katica Nikolovska**

